



**Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)
PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM
20 Mars 2012**



KOMUNIKATË PËR MEDIA JAVA E GRUAS NË KOSOVË 2012

PRISHTINË — Për herë të parë në Kosovë, 100 gra përfaqësuese të partive politike, Kuvendit të Kosovës, qeverisë, nga akademia, shoqëria civile dhe nga biznesi u mbledhën së bashku për një javë për të diskutuar dhe identifikuar mundësitë që do të ndihmojnë gratë të jenë më efektive dhe më të suksesshme në fushën e tyre të zgjedhur.

Java e Gruas 2012 filloj më 20 Mars dhe do të përfundoj me 24 Mars në Prishtinë. Dita e parë, sesioni i parë i Gruas në Lidërsip u mbajt sot. Dita e 2 dhe 4 do të mbahet në Universitetin Amerikan të Kosovës. Dita e pestë do të përmbyllet me një ceremoni në Hotelin Swiss Diamond.

Temat e kësaj jave do të jenë: Gratë në Lidërsip; Gratë në Ekonomi; Gratë në Politikë dhe Shoqëri Civile dhe Gratë në Media.

Panelist të sesionit të ditës së parë ishin Presidentja e Kosovës Znj. Atifete Jahjaga, Maureen Shauket Drejtore e USAID në Kosovë, Teuta Sahatqija Kryetare e Grupit të Grave Deputete dhe Znj. Laura Nichols Drejtore e NDI në Kosovë.

Teuta Sahatqija përmendi punën e Grupit të Grave Deputete duke njohur punën e presidentës për përkrahje që ajo ka dhënë grupit të grave deputete dhe çështjeve gjinore, me rastin e rrezikimit të kuotës, me emërimin e ambasadorëve etj.

“Kjo javë ka për qëllim të nxisë gratë dhe vajzat që frymën e udhëheqjes ta bartin në rrethin e tyre, në familjen e tyre, në shoqërinë e tyre” tha Teuta Sahatqija, kryetare e GGD-së.

Maureen Shauket Drejtore e USAID në Kosovë, tha që gratë duhet të kenë tri gjëra në mendje “Të kesh një qëllim dhe sa më i qartë të jetë qëllimi aq më afër do të jeni drejt realizimit të tij;

të besosh ne veten tënde dhe krijosh aleanca, duke pasur mentor dhe duke krijuar rrjete” tha ajo.

Presidentja Atifete Jahjaga përmendi punën e Grupit të Grave Deputete për krijimin e politikave të balancuara për të adresuar nevojat e shoqërisë sonë.

Duke përmendur Samitin e Grave në Botë 2012, presidentja tha që asnjë shoqëri nuk është e sigurtë nëse gruaja nuk është e sigurtë.

“Një vend mund të përparoj nëse gruaja është e përparuar, nëse është e arsimuar e punësuar dhe e fortë ekonomikisht. Gruaja kosovare vazhdon të jetë viktimë e tranzicioneve. Ne sot duam të flasim me një zë për të gjitha gratë e Kosovës, zeri i së cilave ka mbetur i pa dëgjuar dhe përvoja e së cilave nuk është parë ende” Presidentja Atifete Jahjaga.

NDI në vitin 2010 me një aktivitet një javorë ndihmoi gratë kandidate për Zgjedhjet 2010 në mënyrë që gratë të kenë shkathtësitë e nevojshme për të kandiduar. Këtë vit, NDI në bashkëpunim me Grupin e Grave Deputete kanë bashkëpunuar për të zgjeruar një aktivitet të ngjashëm për gratë e ardhshme lidere.

Pjesëmarrëse të kësaj ngjarje janë Këshillatara të Kuvendit Komunal; Deputetet e Kuvendit të Kosovës; aktivistë të partive politike, gratë që planifikojnë të kandidojnë, profesorë, studentë, gra në biznes dhe nga shoqëria civile dhe përfaqësues nga media. Pjesëmarrësitë e kësaj ngjarje do të përfaqësojnë gjithë rajonet e Kosovës, me përbërje ndëretnike dhe nga gjenerata të ndryshme.

Për më shumë informata për Javën e Gruas ju lutem kontaktoni Arta Qorri në aqorri@ndikv.org apo në nr. e telefonit +377 44 170 703. Facebook Kosovo Women’s Week 2012 <http://www.facebook.com/pages/Kosovo-Womens-Week-2012/192559664187104>; Website: www.weekofwomen.org

###

NDI punon në Kosovë që nga viti 1999 drejt ndërtimit të institucioneve dhe qeverisje demokratike dhe transparente. Programet e NDI në Kosovë përfshijnë fuqizimin e legjislativit, zhvillimin e partive politike dhe pjesëmarrjen qytetare dhe në pjesë të madhe financohen nga Populli Amerikan përmes Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).